



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 pika (c) të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, nenin 29 dhe 54 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 45 paragrafi 4, lidhur me nenin 46 paragrafi 2, të Ligjit Nr-03/L-048, për menaxhimin e financave publike të përgjithshme, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 27/2008”, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, 30.03.2022 miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e llogarisë përfundimtare të të ardhurave dhe të shpenzimeve të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën **Janar–Dhjetor 2021**.

Neni 1

Me këtë vendim miratohet llogaria përfundimtare e Komunës së Suharekës për periudhën **Janar – Dhjetor të vitit 2021**, i cila përmban të dhënat si më poshtë:

Nr.Rd	Mjetet e Komunës	Realizimi 2021	Përqindja
1	Të ardhurat e gjithëmbarshme	18,064,308.44	100.00%
2	Të dalurat e gjithëmbarshme	16,922,196.86	93.68%
3	Teprica e të hyrave ndaj të dalurave	(1,142,111.58)	-6.32%
a	Teprica e të hyrave ndaj të dalurave B.R.K	210,499.91	1.17%
b	Teprica e Financimeve nga huamarretet	31.60	0.00%
c	Teprica nga donacionet	7,766.86	0.04%
d	Teprica e të hyrave ndaj të dalurave Mjet.vetanake 2021	768,422.28	4.25%
e	Tepric e të hyrave ndaj të dalurave Mjet.vetanake 2019	155,390.93	0.86%
	Teprica për bartje në vitin 2021	923,813.21	100.00%

Neni 2

Të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara si dhe teprica e të ardhurave në raport me shpenzimet e administruara të përcaktuara si në nenin 1 të këtij vendimi, janë shpalosur në bilancin e mjeteve të Komunës së Suharekës për periudhën **Janar–Dhjetor** të vitit 2021 dhe raporti si i tillë është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

Realizimi dhe zbatimi i këtij vendimi do të bëhet në pajtim me dispozita e Ligjeve në fuqi dhe Rregulloren e procedurës së përgjithshme për menaxhimin financiar të komunës së Suharekës.

Neni 4

Për zbatimin-implimentimin e këtij vendimi kujdeset qeveria lokale e Komunës së Suharekës.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 400-19125
Me datë 30.03.2022



Kryesuesi i Kuvendit
[Signature]
Mr. **Bexhet KUÇI**